



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr.9
Prishtinë, më 8.5.2013, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali, kryetare, Rita Hajzeraj - Beqaj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Kymete Bajraktari dhe Justina Pula

Mungoi: Biserka Kostiq dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj, Koordinator, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Arsim Gerxhaliu-departamenti i Mjeksisë Ligjore, Alan Robinson-Deparmaneti i mjeksisë ligjore EULEX, Blerim Rexha AKP, Muharrem Arifi-AKP, Reshat Fetahu-AKP, Florije Kryeziu-UNICEF, Lejla Selimi-OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 16 dhe 24 prill 2013;
3. Takim me z.Allen Robinson nga zyra e Departamentit të Mjekësisë Ligjore të EULEX, lidhur me shqyrtimin e raportit vjetor të aktiviteteve të EULEX-it për personat e zhdukur;

4. Takim me përfaqësuesit e AKM-së dhe Sindikatës së punëtoreve të ndërmarrjes Morava e Binqes lidhur peticionin që ka të bëjë rreth privatizimit të N.SH Morava e Binqes;
5. Të ndryshme.

Kryetarja-tha se për hir të të ftuarve mbledhjen e fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se është fjala për raportin vjetor të aktiviteteve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore të EULEX-it në Kosovë, ku kanë njoftuar për aktivitetet e ndërmarrura. Po ashtu, ajo theksoi se për të raportuar për këtë raport e kemi ftuar z.Alan Robinson dhe z. Arsim Gerxhaliun.

Allen Robinson- njoftoj anëtarët e komisionit lidhur me këtë Raport, ai fillimisht bëri elaborimin e punës që bëjnë kjo zyrë, tha se kanë raporte të mira me Ministrin e Drejtësisë Raporti, tha në vijim Robinson, është i hartuar në pesë kapituj, ku përfshihen rezultatet nga operacionet fushore, rezultatet e antropologjisë mjeko-ligjore dhe të identifikimit, raporti special i mbetjeve të paidentifikuara që mbahen në morgun e Departamentit të Mjekësisë Ligjore (DML), të zhdukurit, përkatësisht përshkrimi i situatës dhe Plani i Punës për vitin 2013.

Sa i përket këtij raporti dhe fatit të personave të zhdukur dhe hapat që i ndërmerr zyra e Eulex-it për zbardhjen e fatit të pagjeturve, si dhe bashkëpunimit me komisionin qeveritar për persona të pagjetur në serbi shtruan pyetje; Suzana Novoberdali, Rita Hajzeraj, Albana Gashi, Justina Pula, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyqi dhe Kymete Bajraktari.

Alan Robinson- duke u përgjigjur në pyetjet e bëra nga anëtarët e Komisionit tha se Sipas këtij Raporti, numri i personave të zhdukur vazhdon të mbetet ende i lartë (1754), ndonëse janë kryer 46 gërmime fushore në kërkim të të zhdukurve. Ai po ashtu njoftoi se në morgun e Prishtinës ende qëndrojnë 250 trupa dhe 1010 pjesë të trupave. Këto mbetje mortore, sqaroi Robinson, i përkasin kohës së gërmimeve që vite më parë kishte realizuar Tribunali i Hagës. Lidhur me këto mbetje mortore, po ashtu u tha se janë të dëmtuara, përkatësisht të djegura, gjë që bënë të pamundshëm identifikimin e saktë të tyre. Duke folur për agjendën që synojnë të realizojnë në këtë vit, Robinson u shpreh optimist se do të realizohen gërmime hulumtuese edhe në territorin e Serbisë, përkatësisht në Rashkë. Lidhur me këtë, ai tha:”Kemi bërë edhe përgatitjet shkencore në atë zonë”. Ndër sfidat e Zyrës që ai udhëheq, Robinson, si pengesë në punën e tyre vuri në spikamë perceptimin e përgjithshëm të opinionit se, Zyra Ligjore e Eulex-it, nuk bën asgjë për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Këtë perceptim të opinionit ai e vlerësoi si të pabazë, ndërkaq, bëri thirrje që të mbështetet Departamenti i Mjekësisë Ligjore, si i vetmi institucion që ka përgjegjësinë për zhvarrosjen, identifikimin dhe rivarrosjen e personave të pagjetur.

Arsim Gerxhaliu drejtor i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, -Duke u përgjigjur në pyetjen se në çmasë janë të dëmtuara mbetjet mortore, shpjegoi se të gjitha mbetjet mortore që nuk i janë nënshtruar zjarrit është e mundshme të identifikohen.

Kryetarja- në emër të komisionit falënderoj përfaqësuesin e EULEX-it dhe atë të mjekësisë ligjore, duke ju premtuar ndihmë dhe përkrahje të pa rezervë dhe tha se mbledhjen me tej do ta udhëheq Rita Hajzeraj, pasi që ajo ka një takim dhe i duhet me dal patjetër.

4.Takim me përfaqësuesit e AKM-së dhe Sindikatës së punëtorëve të ndërmarrjes Morava e Binqes lidhur petitionin që ka të bëjë rreth privatizimit te N.SH Morava e Binqes;

Rita Hajzeraj- Sa i përket petitionit të ish- punëtorëve të ndërmarrjes “Morava e Binqës”, ajo tha se ata kanë kërkuar shumë e caktuar në kuadër të 20 % që kanë pasur për të marrë nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje, mirëpo nuk i kanë marrë afërsisht 167 euro, që iu ka mbetur borxh Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ne si komision për këtë kemi ftuar përfaqësuesit e AKP-së që të na sqarojnë më mirë rastin sa i përket këtyre kërkesave të këtyre punëtorëve.

Blerim Rexha- Lidhur me kërkesën e punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje njoftoi se për këto kërkesa lënda e këtyre punëtorëve është duke u shqyrtuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Të drejtat e tyre, tha në vijim ai, punëtorët e ndërmarrjes” Morava e Binqës” do t’i realizojnë në bazë të vendimit të kësaj Gjykate.

Komisioni lidhur me këtë petition nuk nxjerri përfundim, pasi që lënda është duke u shqyrtuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos dashur të ndërhyjë në punët e gjykatës, dhe pret vendimin e gjykatës për këtë lëndë.

Kryesuesja- tha se pikat tjera të rendit të ditës do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali